



UNIVERSITETI I MITROVICËS 'ISA BOLETINI'

Programi mësimor i lëndës (Syllabusi)		
Fakulteti:	Fakulteti Ekonomik	
Programi/Departamenti:	Biznes dhe Menaxhment. Specializimi: Banka, Financë dhe kontabilitet	
Niveli:	Bachelor	
Kodi i lëndës:		
Lënda:	Menaxhimi i Portfolios së Investimeve	
Statusi i lëndës:		Zgjedhore
Semestri:		Dimëror
Fondi i orëve:	2+1	Sipas programit të aprovuar
ECTS:	4	Sipas programit të aprovuar
Orari/Salla	Salla 403 / Amfiteatër 2	
Viti akademik:	Viti i III, Semestri i V	
Mësimdhënës/e:	Prof. Asoc. Dr. Esat A. DURGUTI	
Asistent/e:	Besë SADIKAJ, PhD.C & Milaim MEHMETI, Msc.	
Kontaktet:	Mësimdhënës/e	Asistent/e
E-mail:	esat.durguti@umib.net	besse.sadikaj@umib.net milaim.mehmeti@umib.net
Telefon:	+ 383 (0) 44 152 975	

PERMB AJTJE	Ky modul fokusohet në konceptet themelore në menaxhimin e investimeve dhe portofolit si dhe çështjet ndërlidhëse me: rrezikun e normës së këmbimit, rreziku me normën e kthimit, optimizimi dhe diversifikimi i portofolit. Gjithashtu, moduli do të fokusohet edhe në instrumentet jashtë bilancore, modelet e diversifikimit të portfolios, menaxhimi në aspektin kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe tendencat dhe trendet aktuale të menaxhimit ndërkombëtar të portfolios investive. Qëllimi i modulit është të zhvillojë një kuptim të plotë të parimeve kryesore të menaxhimit të portofolit dhe teorisë së çmimit të aseteve dhe të mësojë se si t'i zbatojë ato në praktikë. Ne do të vendosim një ndërlidhje me teorinë në praktikën duke bërë simulime të teorisë së portofolit në Excel.
QËLLIM I	Qëllimi i lëndës është ofrimi i njohurive të përgjithshme studentëve me konceptet teorike dhe praktike të teorisë moderne të portofolit, grupet kryesore të investitorëve, objektivat dhe kufizimet e tyre të investimit. Gjithashtu, lënda ka për qëllim zotërimin e aftësive praktike në menaxhimin e investimeve, krijimin e pritjeve nga tregu i kapitalit, aktivitetet e parashikimit të tregjeve për të justifikuar strategjinë kryesore të menaxhimit të portofolit të investimeve për instrumentet e kapitalit dhe me të ardhura fikse. Një tipar dallues i lëndës është fokusimi në çështjet praktike të menaxhimit të portofolit të investimeve, bazuar në rezultatet e kërkimeve të fundit akademike në fushën e menaxhimit të portofolit.

ARRITS HMËRI A	❑ Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që: 1. <u>Të përshkruajnë</u> mekanizmin operacional të tregjeve të letrave me vlerë dhe instrumenteve derivative (Forwards, Futures and Options), 2. <u>Të zhvillojnë</u> aftësinë për të interpretuar pasqyrat financiare dhe informacionin financiar, 3. <u>Të interpretojnë</u> aftësitë analitike dhe të menduarit kritik të nevojshëm për të vlerësuar dhe vlerësuar vendimet alternative të investimeve, 4. <u>Të zbatojnë</u> aftësitë të komunikimit me shkrim përmes përgatitjes së projekteve investuese, 5. <u>Të argumentojnë</u> njohuri për vlerësimin e portofolit të kapitalit dhe të ardhurave fikse, dhe 6. <u>Të krijojnë analiza</u> mbi vlerësimin e performancës, matjet e performancës, analizën e stilit dhe kohën.	
PROGR AMI	Javët	Tema
	Java - I	Pasqyrë përmbledhëse e përmbajtjes së lëndës – Ligjëratë hyrëse (Syllabusi)
	Java - II	Tregjet dhe transaksionet ndërkombëtare: Vështrim i përgjithshëm i tregjeve, investitorëve dhe indekseve
	Java - III	Tregjet dhe instrumentet me të ardhura fikse
	Java - IV	Tregjet e obligacioneve të korporatave: Instrumente dhe analiza
	Java - V	Tregjet e parasë: Instrumentet dhe analiza
	Java - VI	Instrumentet jashtë bilancit: Forwards, Futures dhe Opsionet
	Java - VII	Zgjedhja dhe diversifikimi i portofolit
	Java - VIII	<i>Kollokviumi i Parë</i>
	Java - IX	Konceptet e modelit të çmimit të aseteve kapitale dhe modeli APT
	Java - X	Menaxhimi i portofoleve të obligacioneve ndërkombëtare
	Java - XI	Matja e kthimeve nga portofolet ndërkombëtare
	Java - XII	Si të matet rreziku dhe aktiviteti në menaxhimin aktiv të Portofolit
	Java - XIII	Vlerësimi i performancës: matjet e performancës, analiza e stilit dhe koha e tregut
	Java - XIV	Tendencat aktuale brenda menaxhimit ndërkombëtar të aseteve
<u>Java - XV</u>	<i>Kollokviumi i Dytë (Provimi final)</i>	

LITERATURA	Literatura themelore: 1. Reilly, K Franklin, Brown, C Keith, and Leeds, J Sanford (2020). Investment Analysis and Portfolio Management – Cengage Learning Inc, 2020. 2. Khan, R dhe Grinols, R (2020). Advances in Active Portfolio Management: New Developments in Quantitative Investing- McGraw-Hill Education. Literatura plotësuese: 1. Ligjeratat e autorizuar. 2. Nan Yin (2015). The empirical analysis on the portfolio optimization's effective border. Vibroengineering PROCEDIA, Vol. 5, 2015, p. 564-568.
METODOLOGJIA E MËSIMDHËNJES	Metodologjia e përdorur në mësimdhënie dhe mësim nxënie do të jetë ajo e praktikave më të mira: ligjërata interaktive, diskutime, detyra kursi, projekte të pavarura, ushtrime, konsultime dhe punime kërkimore në grup. Mësimi do të zhvillohet përmes ligjëratave, detyrave praktike, interpretimeve individuale dhe grupore, vetëvlerësimeve periodike, etj. Të gjitha këto do të realizohen në aspektet teorike dhe praktike duke i paraqitur materialet në formë audio vizuale përmes kompjuterit, projektorit dhe në tabelë. Në kuadër të këtij semestri janë të paraparë 15 Javë me nga 2 orë ligjërata dhe 1 ushtrime (seminare dhe diskutime), si dhe dy kolloqfume të cilat mbahen brenda 15 ligjëratave të planifikuara (javën e 7 dhe 15). Studimet e rastit dhe detyrat e shtëpisë jepen pas çdo ligjërate për studentët me qëllim që studentët të studiojnë dhe hulumtojnë në kohën e studimeve vetanake. Rezultatet nga aktivitetet e tilla paraqiten dhe diskutohen në javën vijuese. Studentët inkurajohen për të ndjekur zhvillimet aktuale ekonomike duke lexuar artikuj, revistat ekonomike si dhe materiale të tjera relevante. Ata mund të identifikojnë çështjet/temat e radhës për diskutim nga lexime të tilla. Esetë e përgatitura nga studentët gjithashtu do të diskutohen si dhe inkurajohen prezantimet individuale dhe grupore.

	Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit - 1 ECTS kredi = 25 orë)			
	Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
	Ligjërata	2	15	30
	Ushtrime	1	15	15
	Konsultime me mësimdhënësin/asistenten	1	15	15
	Kolokfiume /seminare	2	2	4
	Detyra të pavarura			
	Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	6	24
	Përgatitja përfundimtare për provim	2	4	8
	Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	/	/	/
	Projektet, prezantimet, etj	1	8	8
	Totali			104 orë:25 = 4.16 ECTS
VLERËSIMI	Vlerësimi dhe vlerësimi i njohurive dhe aftësive do të bëhet sipas kësaj kronologjie: ▪ Pjesëmarrja dhe interaktiviteti gjatë leksioneve 10%, ▪ Punime dhe projekte kërkimore në grup 10%, ▪ Testi i parë i vlerësimit 40% dhe ▪ Testi i dytë i vlerësimit 40%, dhe ▪ Gjithsej 100% e pikëve. Shkallët e notave: ▪ 50-gradë e ulët 5 (pesë) ▪ 51-60% - klasa 6 (gjashtë) ▪ 61-70% - klasa 7 (shtatë) ▪ 71-80% - klasa 8 (tetë) ▪ 81-90% - nota (nëntë) ▪ 91-100% - nota (dhjetë)			
POLITIKAT AKADEMIKE	Studentët pritet të marrin pjesë rregullisht në ligjërata. Ata pritet gjithashtu të jenë aktiv në ligjërata, seminare dhe diskutimeve individuale dhe grupore. Profesori është në dispozicion për konsultime individuale. Studentët janë të detyruar për të lexuar literaturë para çdo ligjërate. Studenti është i obliguar të vijojë ligjërata dhe ushtrime. Plagjiatura dhe kopjimi në provime janë të dënueshme sipas statutit dhe rregulloreve të tjera të universitetit. Kodi e mirësjelljes vlen si për studentët ashtu edhe për mësimdhënësit.			

Mitrovicë

10/10/2021

Bartës/e i/e lëndës:

Prof. Ass. Dr. Esat A. DURGUTI

(Emër Mbiemër)

(Nënshkrimi)